



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 187/1 Prot

Tiranë, më 27.02.2020

V E N D I M

Nr.28, datë 27.02.2020

**MBI VERIFIKIMIN E STATUSIT TË PUNËSIMIT TË PUNONJËSES SË
BASHKISË LEZHË, *******

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procedurës së verifikimit,

VËREJ SE:

Me anën e kërkesës së regjistruar me nr. 1569 prot., datë 5.11.2019, punonjësja ***** , aktualisht me detyrë, “Specialiste, në Sektorin e Përpunimit të Dokumentave të Tokës dhe Pronave”, në Drejtorinë e Bujqësisë, pranë Bashkisë Lezhë, ka ngritur pretendimin se konkluzioni i nxjerrë nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në vendimin paralajmërues nr. 203, datë 9.10.2017, në përfundim të procesit të mbikëqyrjes në Bashkinë Lezhë dhe në vendimin nr. 93, datë 15.10.2019, dalë në përfundim të inspektimit tematik për emërimet në kundërshtim me ligjin në këtë njësi të qeverisjes vendore, që emërimi i saj në pozicionin e sipërpërmendur në këtë bashki është i kundraligjshëm, nuk është i drejtë.

Punonjësja në fjalë parashtron se, ajo e ka fituar statusin e nëpunësit civil për shkak të ligjit, në pozicionin “Përgjegjëse e zyrës së MMT”, në ish Komunën Shënkoll dhe mbi këtë bazë, njësia e burimeve njerëzore të komunës ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, nëpunës civil i konfirmuar, në atë pozicion. Spas saj, lëvizjet e mëvonshme nga ish komuna në bashki, janë kryer në kuadër të lëvizjeve paralele, prandaj konkluzioni se punësimi në pozicionet “Specialiste, në Sektorin e Përpunimit të Dokumentave të Tokës dhe Pronave” e më pas kalimi në pozicionin “Specialiste, në Sektorin e Përpunimit të

Dokumentave të Tokës dhe Pronave”, në Drejtorinë e Bujqësisë së kësaj bashkie është i kundraligjshëm, duhet të rishikohet.

Për verifikimin e pretendimit të mësipërm, u rishqyrtuan Raporti Përfundimtar i Mbikëqyrjes së kryer pranë Bashkisë Lezhë, përfunduar me vendimin paralajmërues nr. 203, datë 9.10.2017 dhe konkluzionet e inspektimit tematik në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve të parregullta në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në këtë njësi të qeverisjes vendore, të evidentuara në vendimin nr. 93, datë 15.10.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Pas kësaj u kalua në rishqyrtimin e akteve të dosjes së personelit, prej nga rezultoi e vërtetuar sa më poshtë:

Punonjësja *****, ka filluar marrëdhënien e punës në Komunën Shënkoll, me aktin e emërimit nr. 9, datë 30.4.2007, të kryetarit të kësaj komune, në pozicionin, *“Përgjegjëse e Zyrës së Mbrojtjes dhe Administrimit të Tokës”* dhe fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar (data 26.2.2014), e ka gjetur të punësuar në këtë pozicion për më shumë se një vit. Mbi këtë bazë njësia përgjegjëse e komunës, me aktin nr. 323 prot., datë 17.4.2015, e ka deklaruar punonjësen në fjalë, nëpunës civil në pozicionin, *“Përgjegjëse e Zyrës së Mbrojtjes dhe Administrimit të Tokës”*.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.115/2014, *“Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”*, shtrirja territoriale e Bashkisë Lezhë, ka përfshirë ndër të tjera edhe Njësine Administrative Shënkoll (ish Komuna Shënkoll).

Në kushtet e reja, nëpunësja *****, me aktin nr. 101, datë 5.5.2016, të Kryetarit të Bashkisë Lezhë, është emëruar në pozicionin *“Përgjegjëse e Sektorit të Pranimit dhe Përpunimit të Dokumentave të Tokës dhe Pronave (Kadastrës)”*, në Drejtorinë e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ujitjes pranë Bashkisë Lezhë, dhe më pas me aktin nr. 23, datë 12.1.2018 të Kryetarit të Bashkisë ka kaluar në pozicionin, *“Specialiste, në Sektorin e Përpunimit të Dokumentave të Tokës dhe Pronave”*, në Drejtorinë e Bujqësisë të kësaj bashkie.

Në të dy rastet lëvizjet e mësipërme, nga pozicioni i mëparshëm në Njësine Administrative Shënkoll në bashki, janë kryer pa respektuar procedurën e përcaktuar në legjislacionin e shërbimit civil dhe për rrjedhojë, aktet përkatëse përbëjnë veprime administrative absolutisht të pavlefshme.

Por, pavarësisht sa më sipër, nga përmbajtja e dokumentacionit të dosjes së personelit, është konstatuar gjithashtu, se shtetasja *****, me vendimin nr. 233, datë 8.5.2014, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 501, datë 22.12.2014, për veprën penale, *“Shpërdorim të detyrës”*, është deklaruar fajtores dhe është dënuar nga Gjykata e

Rrethit Gjyqësor Lezhë, (me 2 vite burgim; pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë vepër tjetër penale dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës).

Në këto kushte, duke bërë një analizë dhe vlerësim në tërësi të gjithë materialeve të mësipërme, tabloja e çështjes merr pamjen e mëposhtme:

Statusin e nëpunësit civil, që punonjësja e ish Komunës Shënkoll, *****, e ka fituar me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, pavarësisht datës së deklarimit të këtij statusi, e ka humbur në momentin kur është dënuar penalisht me vendim të formës së prerë nga gjykata kompetente, pavarësisht llojit të dënimit të aplikuar në këtë rast.

Ky konkluzion bazohet në pikën “c” të nenit 63, Kreu XII, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, i cili bën fjalë për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të pranisë së një shkakut të parashikuar nga neni 65 i këtij ligji.

Në pikën “d” të nenit 65 të ligjit në fjalë është parashikuar shprehimisht se marrëdhënia në shërbimin civil përfundon kur nëpunësi civil, “d) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale”.

Pra, duke filluar nga momenti i marrjes formë të prerë të vendimit penal nr. 233, datë 8.5.2014, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 501, datë 22.12.2014, marrëdhënia në shërbimin civil e nëpunëses *****, ka përfunduar për shkak të ligjit dhe gjithë aktet e mëvonshme administrative, nëpërmjet të cilave kjo punonjëse ka kaluar në pozicione të ndryshme të shërbimit civil, pa respektuar procedurën e konkurrimit, në bazë të neneve 108, pika pika a)ii dhe 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, janë akte të absolutisht të pavlefshëm dhe si të tilla nuk merren parasysh.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA

1. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në Bashkinë Lezhë, për të rregulluar gjëndjen e ligjshmërisë, të veprojë sipas masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit nr. 93, datë 15.10.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e

Shërbimit Civil dhe të ndërpresë marrëdhënien e punësimit për punonjësen,
*****.

2. Të shpallë të lirë pozicionin e punës, “*Specialist, në Sektorin e Përpunimit të Dokumentave të Tokës dhe Pronave*” dhe të marrë masat për plotësimin e tij sipas procedurave konkurruese të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
3. Të njoftohen për këtë vendim, Bashkia Lezhë, njësia e burimeve njerëzore të kësaj bashkie dhe punonjësja, *****.
4. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër, institucionit i lihet afat, **10** ditë, nga momenti i komunikimit të këtij vendimi.
5. Me kalimin e këtij afati, duhet të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mënyrën e zbatimit të vendimit.
6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha